




RADIO URBAN FM
Abdus RAMADANI
Drejtor
Prizren



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2020/78 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për RADIO URBAN FM (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Bazuar në Ligjin e KPM-së konkretisht në nenin 28 të Ligjit të KPM-së Pala Përgjegjëse është e obliguar të dorëzojë raportin vjetor në KPM, përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera.
2. KPM ka gjetur se edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, duke mos e dorëzuar raportin vjetor për vitin 2019, deri me 31 mars të vitit përkatës, dhe as pas afatit shtesë të caktuar nga KPM deri me 30 qershor 2020.
3. KPM, bazuar në shkeljet e Ligjit të KPM-së nga ana e Palës Përgjegjëse, me datë 11 shtator 2020 i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse për mosjellje të raportit vjetor. Përmes Njoftimit është kërkuar që të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së do të ndërmarre masa ligjore.
4. Edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje Pala Përgjegjëse nuk ka ardhur në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, duke mos e sjellë raportin vjetor për vitin 2019, ashtu siç parashihet me nenin 28 të Ligjit të KPM-së.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së, pasi që ka dështuar të dorëzojë raportin vjetor për vitin 2019, ashtu si parashihet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të KPM-së.

Neni 28 paragrafi 1, i Ligjit të KPM-së përcakton se:

“Shërbimet e licencuara mediale audiovizuale duhet t’i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me ligj”.

Neni 28 paragrafi 2, i Ligjit të KPM-së përcakton se:

“Raportet vjetore duhet të dorëzohen në KPM-së jo më larg se me datë 31 mars të vitit vijues, për vitin paraqarak. KPM-ja mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nëse konsideron se informacioni i paraqitur në raportet vjetor nuk është i plotë.”

6. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse me mos sjellje të raportit vjetor ka bërë shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të KPM-së.

Vendim

7. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të KPM-së.
8. Obligohet Pala Përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi, ta dorëzojë raportin vjetor për vitin 2019, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



13.11.2020
Datë